

VENDIM NR. 6

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më datë 03.05.2019 në selinë e Shoqërisë "Elektro-Servis" Sh.p.k. me NUIS K81313011R (më tej referuar si "Shoqëria"), janë të pranishme palët e mëposhtme ortake të Shoqërisë:

- **Balfin Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, më datë 15.04.2008, me NIPT nr. K72223031K dhe seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Kati 12, Tiranë, Shqipëri, ortake dhe zotëruese në masën 90% (*nëntëdhjetë përqind*) të kuotave të kapitalit themeltar të saj, përfaqësuar rregullisht në përputhje me paragrafin 9.2 (d) të Nenit 9 të statutit të Shoqërisë Balfin Sh.p.k nga administratorja Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. Juljan MANE**, shtetas shqiptar, lindur më dt. 15.01.1977, në Korçë, Shqipëri, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër 028907609, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak i Shoqërisë dhe zotërues në masën 10% (*dhjetë përqind*) të kuotave të kapitalit themeltar të saj.
- **Z. Bers Hado** në cilësinë e këshilltarit ligjor të shoqërisë Balfin sh.p.k.;

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton z. Bers Hado, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

REND DITE:

1. **KORRIGJIMIN E VENDIMIT NR. 1, DATE 31.07.2018 PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SHOQËRISË;**
2. **TË NDRYSHME;**



1. KORRIGJIMIN E VENDIMIT NR. 1, DATE 31.07.2018 PER ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SHOQËRISË;

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës, Kryetari parashtron se, nëpërmjet Vendimit nr. 1 date 31.07.2018 te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve te Shoqërisë është miratuar zmadhimi i kapitalit me shifrën 85.000.000 Leke (tetëdhjetë e pese milion leke) duke e çuara kapitalin e Shoqërisë ne shumen totale 85.100.000 Leke (tetëdhjetë e pese milion e njëqind mije leke). Megjithatë, ne vendimin e sipërpërmendur janë shprehur ne mënyrë te pasakte çështjet si ne vijim:

- a) *“Me rritjen e kapitalit te Shoqërisë ortaket e Shoqërisë do te zotërojnë ne kapitalin e shoqërisë vlerat e kapitalit ne përputhje me sa me poshtë:*
- **Balfin sh.p.k do te zotëroje 76.500.000 Leke (shtatëdhjetë e gjashte milion e pesëqind mije leke) te cilat përbejnë 90% te kapitalit te zmadhuar te Shoqërisë;**
 - **Z. Juljan Mane do te zotëroje 8.600.000 Lek (tete milion e gjashtëqind mije leke) te cilat përbejnë 10% te kapitalit te zmadhuar te Shoqërisë”**

Dhe

- b) *Ortaket bien dakord qe kontributi i ortakeve do te paguhet nga Balfin Sh.p.k., edhe për pjesën e ortakut Juljan Mane, pa ngarkuar këtë te fundit me asnjë detyrim ndaj ortakut Balfin Sh.p.k. Ortaket parashikojnë te paguajnë te gjithë vlerën e kapitalit te shoqërisë brenda vitit kalendarik 2018.*

- ❖ **Ne lidhje me pasaktësinë e përmendur ne piken a) me sipër, Kryetari i Asamblesë sqaron se:** Efektivisht zmadhimi i kapitalit me shifrën 85.000.000 Leke (tetëdhjetë e pese milion leke) duke e çuara kapitalin e Shoqërisë ne shumen totale 85.100.000 Leke (tetëdhjetë e pese milion e njëqind mije leke) do te ruante raportet ekzistuese te pjesëmarrjes se ortakeve ne kapitalin e Shoqërisë, duke rezultuar ne një ndarje ku:

- **Z. Juljan Mane** do te ishte zotërues i një kuote qe përben 10% te pjesëmarrjes ne kapital te barasvlershme me **8.510.000 Lek (tete milion e pesëqind e dhjete mije leke).**
- **Balfin Sh.p.k.**, zotëruese e një kuote qe përben 90% te pjesëmarrjes ne kapital e barasvlershme me **76.590.000 Leke (shtatëdhjetë e gjashte milion e pesëqind e nëntëdhjetë mije leke).**

- ❖ **Ne lidhje me pasaktësinë e përmendur ne piken b) me sipër, Kryetari i Asamblesë sqaron se:** Ndryshe nga dakordesia e ortakeve, ne Vendimit nr. 1 date 31.07.2018 te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve te Shoqërisë është zbardhur ne mënyrë te pasakte mënyra e pagese se kontributit për zmadhim. Per rrjedhim Ortaket saktësojnë se zmadhim i kapitalit **do të kryej nëpërmjet kontributit ne para nga ana e secilit Ortak te shoqërisë ne përputhje me raportin e pjesëve te kapitalit te zotëruara prej tyre,** pra përkatësisht: 90% nga Balfin Sh.p.k ne shumen 76.500.000 Lek (shtatëdhjetë e gjashte milion e pesëqind mije leke); dhe 10% nga z. Juljan Mane ne shumen 8.500.000 Leke (tete milion e pesëqind mije leke). Gjithashtu Ortaket kishin

parashikuar qe secili ortak kishte te drejte te paguante kontributin sipas pjesëmarrjes përkatëse ne kapitalin e Shoqërisë brenda vitit kalendarik 2019.

Si rrjedhim i sa u sqarua me sipër lind nevoja e një korrigjimi të të dhënave të Vendimit nr. 1 date, 31.07.2018 te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve te Shoqërisë dhe te dhënave te reflektuara ne regjistrin tregtar te mbajtura nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Për këto arsye, propozohet që te merret vendim për korrigjimin e vendimit te sipërpërmendur.

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjeve në Rend të Ditës, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve :

VENDOSI

1. Të miratojë korrigjimin e **Vendimit nr. 1 date 31.07.2018 te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve te Shoqërisë** duke saktësuar se:

“Kapitali i shoqërisë zmadhohet me 85.000.000 Leke (tetëdhjetë e pese milion leke) duke e çuara kapitalin e Shoqërisë ne shumen totale prej 85.100.000 Leke (tetëdhjetë e pese milion e njëqind mije leke) nëpërmjet kontributeve ne para te ortakeve ne përputhje me raportin e pjesëve te kapitalit te zotëruara prej tyre, pra përkatësisht: 90% nga Balfin Sh.p.k ne shumen 76.500.000 Lek (shtatëdhjetë e gjashte milion e pesëqind mije leke); dhe 10% nga z. Juljan Mane ne shumen 8.500.000 Leke (tete milion e pesëqind mije leke) duke rezultuar ne një pjesëmarrja te ortakeve pas zmadhimit si ne vijim:

- **Balfin sh.p.k** zotëruese e një kuote qe përben 90% te pjesëmarrjes ne kapital e barasvlershme me **76.590.000 Leke (shtatëdhjetë e gjashte milion e pesëqind e nëntëdhjetë mije leke)** ; dhe
- **Z. Juljan Mane** zotërues i një kuote qe përben 10% te pjesëmarrjes ne kapital e barasvlershme me **8.510.000 Lek (tete milion e pesëqind e dhjete mije leke).**

Ortaket parashikojnë qe secili ortak ka te drejte te paguaje kontributin sipas pjesëmarrjes përkatëse ne kapitalin e Shoqërisë brenda vitit kalendarik 2019.”

2. Të autorizojë Z. Juljan Alvora, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë, që të ndërmarri të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ose të autorizojë persona të tjerë përkatësisht për kryerjen e këtyre veprimeve në funksion të realizimit të qëllimit të mësipërm.


* * * * *

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakeve të "Elektro -Servis" Sh.p.k" SHPK mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
ELEKTRO-SERVIS SH.P.K.**

KRYETARI



Znj. Edlira MUKA
Administratore e Ortakut

Balfin Sh.p.k.





Z. Juljan MANE



Ortak

SEKRETAR

Z. Bers HADO